

VENDIM
Nr.2, datë 16.1.2008

**PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “KESH” SHA PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9, pika 3, nenit 13, pika 1, germa “dh”, si dhe nenit 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 10, pika 2 dhe neni 16 të “Rregullores së procedurave të licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve me nr.21, datë 4.4.2007, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, pika 1, germa “a”, pika 2 dhe pika 3, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a., për rinovimin e licencës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “KESH” sh.a., për rinovimin e licencës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë me shkrim aplikuesin (shoqërinë “KESH” sh.a.), për plotësimin e dokumentacionit në përputhje me rregullat e procedurave të licencimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta